



V E N D I M
Nr. 8 Date 29.01. 2010

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË KONSUMIT VJETOR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË
KLIENTIT TË KUALIFIKUAR PËR VITIN 2010**

Në mbështetje të nenit 48, pika 1, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe Ligjit nr.9501 datë 3.4.2006 “Për Ratifikimin e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 29.1.2010, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Vendosi :

1. Për vitin 2010, të gjithë klientët tariforë (familjare dhe jo-familjarë) të energjisë elektrike kanë të drejtë të përfitojnë statusin e Klientit të Kualifikuar pavarësisht nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

V E N D I M
Nr. 8 Date 29.01. 2010

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË KONSUMIT VJETOR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË
KLIENTIT TË KUALIFIKUAR PËR VITIN 2010**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve

